



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Priljeno.		
07.08.25		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/d-41485		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Festivali i këngës për fëmijë “ Lipjani Këndon 2025”

Bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport bën thirrje për të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat kanë selinë dhe adresën në territorin e Komunës së Lipjanit dhe programi i punës së të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin **FESTIVALI I KËNGËS PËR FËMIJË “LIPJANI KËNDON” 2025**,

Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt përmes aktiviteteve si më poshtë:

Objektivat:

- Promovimi i talenteve të rinjë në muzikë
- Realizimi i garave mes fëmijëve

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **5,000.00 euro**.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **501.00 euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **5,000.00 euro**.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë pune deri më 27.08.2025**.

Periudha e zbatimit të projektit është deri në 1 muaj.

OJQ-të duhet gjithashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ **nuk është nën hetime për vepra penale.**

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët, së bashku me **Udhëzimet për Aplikantët**, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (webfaqja: www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga "Shqipëria"

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr. 1 dhe nr. 2

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të tyre, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në **Udhëzimet për Aplikuesit** të thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar **brenda afatit të përcaktuar** me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin **plotësisht** kushtet e përcaktuara.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën:

mergim.oruci@rks-gov.net

Lipjan, më **07.08.2025**

Anila Reçiça Llugiçi
Drejtoreshë e DKRS-së

